



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.09.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për komandimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:35 dhe mbaroi në orën 14:55.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
11. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për komandimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje të gjithëve. Duke qenë se të gjithë anëtarët janë të pranishëm, fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 16 shtator 2020.

Siç jeni vënë në dijeni, në rend dite janë dy çështje për të cilat kërkohet vendimmarrje nga ana e Këshillit. Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për komandimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}”, dhe çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Për të dyja këto çështje, relator do të jetë zoti Toska.

Për më shumë detaje ia jap fjalën zotit Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për komandimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}”.

Lidhur me këtë projektvendim është përpiluar edhe relacioni shpjegues i cili i është shpërndarë anëtarëve paraprakisht, po kështu edhe dokumentat shoqërues.

Atëherë, lidhur me projektvendimin mund t’ju them se me datë 14.09.2020, në rrugë elektronike dhe më pas më datë 15 shtator 2020 edhe fizikisht, gjyqtarja {...} ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor formularin e kandidimit për pjesëmarrjen në skemën e delegimit, nëpërmjet të cilit ka dhënë pëlqimin për të shërbyer në skemën e delegimit në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë.

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtarja {...} ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës, më datë 08.07.2008, ndërsa është diplomuar magjistrat/profili gjyqtar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2011. Znj. {...} ka marrë emërimin e përkohshëm për stazhin profesional me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 6689, datë 27.09.2010, duke u caktuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 7202, datë 21.12.2011, ajo është emëruar përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, ku ushtron detyrën dhe aktualisht.

Neni 45 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullon institutin e skemës së delegimit, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen nga magjistrati për t’u pranuar në këtë skemë, si dhe detyrimin e Këshillit për të miratuar rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e magjistratëve si dhe kohën e shërbimit për skemën e delegimit, duke parashikuar ndër të tjera se:

“1. Magjistratët në të gjitha shkallët, me të paktën një vit përvojë në funksion, mund të kandidojnë për t’u komanduar në një pozicion, në skemën e delegimit, e cila krijohet në Këshill. 2. Magjistrati shërben në skemën e delegimit jo më shumë se 5 vjet. 3. Magjistrati që kandidon për pozicione në skemën e delegimit, nënshkruan një deklaratë për dhënien e pëlqimit për t’u caktuar në çdo gjykatë ose prokurori.”

Në zbatim të nenit 45 të Ligjit nr.96/2016 të sipërcituar, Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 22 datë 07.02.2019, ka miratuar Rregulloren “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”. Konkretisht, neni 4 i kësaj Rregulloreje parashikon kriteret e kandidimit në skemën e delegimit, si vijon:

“Në skemën e delegimit kandidon çdo gjyqtar që plotëson këto kriteret:

- a. Të ketë dhënë pëlqimin për t’u komanduar në skemën e delegimit;
- b. Të ketë jo më pak se 1 vit përvojë në funksion;
- c. Të mos jetë nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të përfshirjes në skemën e delegimit;
- d. Të mos ushtrojë funksionin e Kryetarit apo Zëvendëskryetarit;
- e. Të mos jetë i caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi cenon funksionalitetin e saj;

f. Të mos jetë duke ushtruar funksionin e tij si gjyqtar në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim”.

Bazuar në rrethanat e faktit të parashtruara më sipër, në lidhje me parashikimet ligjore të nenit 45 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në lidhje me parashikimet e Vendimit nr. 22, datë 07.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni vlerëson se në rastin konkret, jemi në kushtet e pranimit të përfshirjes së gjyqtares {...} në skemën e delegimit, pra të komandimit të saj në këtë skemë pasi: gjyqtarja ka dhënë pëlqimin për t’u komanduar në skemën e delegimit; ka më shumë se 1 vit përvojë në funksion; nuk ndodhet nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të përfshirjes në skemën e delegimit; nuk ushtron funksionin e Kryetarit apo Zëvendëskryetarit; është e caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi nuk cenon funksionalitetin e saj pasi aktualisht rezulton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier ushtrojnë funksionin 12 gjyqtarë, ndërsa organika e saj është 15 gjyqtarë; nuk rezulton të jetë duke ushtruar funksionin e saj si gjyqtare në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim.

Sa më sipër, konkludohet se gjyqtarja {...} plotëson kriteret për t’u komanduar në skemën e delegimit.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor që të vendosë:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtares znj. {...}.
2. Komandimin e gjyqtares znj. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.
3. Përfshirjen e gjyqtares znj. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
4. Gjyqtarja e skemës së delegimit, znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për të cilat ka përfunduar apo është në përfundim hetimi gjyqësor.
5. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë kemi ndonjë propozim me projekt-aktin e propozuar nga Komisioni?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi vendimin “Për komandimin në skemën e delegimit të gjyqtarës znj. {...}”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.09.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Apelit Korçë”, i përgatitur nga i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:35 dhe mbaroi në orën 14:55.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
11. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Apelit Korçë”, i përgatitur nga i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në relatin e çështjes së dytë që ka të bëjë me projektvendimin “Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Apelit Korçë”. Sërish fjalën ia jap zotit Toska.

Illir Toska: Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur edhe projektvendimin e dytë që varet edhe nga miratimi i projektvendimit të mëparshëm, që ka të bëjë me caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit, tashmë zonjës {...}, në Gjykatën e Apelit Korçë.

Lidhur me këtë projektvendim, si shkak për propozimin e tij është situata në të cilën gjendet Gjykata e Apelit Korçë, e cila aktualisht është jashtë funksionit, ndërsa në detyrë, nga gjashtë gjyqtarë që është organika e saj, janë vetëm dy gjyqtarë, një numër ky i pamjaftueshëm për formimin e një trupi gjykues, ndërkohë që referuar Kodeve të Procedurës Civile dhe Penale, gjykata e apelit gjykon me trup gjykues të formuar nga tre gjyqtarë.

Për shkak të kësaj situatë në Gjykatën e Apelit Korçë, Këshilli më herët, me Vendimin nr.75, datë 20.02.2020, vendosi që: “Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë për periudhën deri më datë 15.09.2020”. Dhe po ashtu, me Vendimin nr. 291, datë 08.09.2020, Këshilli vendosi: “Zgjatjen e afatit të caktimit të gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Apelit Korçë, deri më datë 30.06.2021”. Por, me Vendimin nr. 315, datë 14.09.2020,

Këshilli vendosi: “Pezullimin nga detyra të magjstrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, caktuar në skemën e delegimit në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Për rrjedhojë, aktualisht në Gjykatën e Apelit Korçë kanë mbetur sërish në detyrë vetëm dy gjyqtarë. Në një situatë të tillë, Gjykata e Apelit Korçë është në nevojë për pasjen në vijimësi në detyrë pranë saj minimalisht edhe të një gjyqtari, çka do të mundësonte gjykimin e çështjeve të regjistruara përpara saj, por, në veçanti, të çështjeve urgjente, që sipas njoftimeve dhe kërkesave më të fundit nga kjo gjykatë rezultojnë të jenë më së paku dhjetë çështje të tilla, në lëndë penale, për caktim mase sigurimi.

Meqenëse gjyqtarja znj. {...}, në supozimin e miratimit nga Këshilli të projektvendimit “Për komandimin në skemën e delegimit”, çka u miratua, do të jetë gjyqtarja e vetme në skemën e delegimit, nisur nga nevoja imediate të Gjykatës së Apelit Korçë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar caktimin e saj në Gjykatën e Apelit Korçë, për të gjithë periudhën njëvjeçare të komandimit në këtë skemë.

Lidhur me këtë vlen të theksohet se gjyqtarja znj. {...} ka përvojë profesionale mbi 7 vjet, pra ka përvojën minimale profesionale që kërkon ligji, neni 47, pika 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit, rrethanë kjo që i jep të drejtë Këshillit ta caktojë atë në gjykatën e apelit për periudhën e komandimit në skemën e delegimit, sikurse përcaktohet në shkronjën “a”, pika 4, të nenit 45, të këtij ligji, sipas të cilës: “4. Këshilli cakton magjistratin në skemën e delegimit në bazë të nevojave të një gjykate ose prokurorie: a) në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin magjistrati përmbush kërkesat; ...”.

Po ashtu, mund të përmendet se gjyqtarja znj. {...} ka kandiduar për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 176, datë 28.05.2020, për të cilin është kandidate e vetme.

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në katër pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet se gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë për periudhën (do të caktojmë datën, që i bie data korresponduese mbas 1 viti që ne po bëjmë këtë caktim, që është data 16 shtator 2021), pikërisht deri në datën kur përfundon komandimi i saj në

skemën e delegimit, pra sipas vendimmarrjes së mëparshme tonën, për komandimin e gjyqtarës znj. {...} në skemën e delegimit.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën e Apelit Korçë për periudhën deri më datë 20.10.2020, kjo për të evituar ngarkesën e saj dhe mundësuar përfundimin së gjykuari të çështjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, sikurse është parashikuar në pikën 4, të projektvendimit “Për komandimin në skemën e delegimit të gjyqtarës znj. {...}”, ku përcaktohet se: “Gjyqtarja e skemës së delegimit, znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që kanë shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për të cilat ka përfunduar apo është në përfundim hetimi gjyqësor”.

Pika 3 e projektvendimit bën fjalë për fillimin e efekteve juridike të vendimit, pikërisht nga data e njoftimit.

Ndërkohë në pikën 4 të projektvendimit përcaktohet se efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Apelit Korçë. Përcaktimi i këtij rregullimi merr në konsideratë faktin se kjo gjykatë ka buxhetin për të përballuar efektet financiare të vendimit, ndërsa ka dy pozicione të lira të përhershme. Por, përveç kësaj, ky rregullim mundëson në të ardhmen plotësimin e vakancës që krijohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

Ndërsa në pikën 5 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e tij i njoftohet gjyqtarës së skemës së delegimit, znj. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Apelit Korçë.

Së fundi në projektvendim përcaktohet publikimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kemi ndonjë diskutim në lidhje me projekt-propozimin?

(Zoti Bici kërkon fjalën por është në pamundësi për të shprehur sugjerimin e tij për shkak të një problemi në linjën e internetit. I jepet fjala zoti Toska për të shprehur atë çka zoti Bici sugjeron.)

Naureda Llagami: Ilir, mund ta sqarosh ti?

Ilir Toska: Zoti Bici kishte një koment për datën e përfundimit të caktimit në Gjykatën e Apelit Korçë, të gjyqtares së skemës së delegimit, znj. {...}. Kishte komentimin që mos duhet të përfundojë më datë 15 shtator 2021.

Kam vlerësuar që afati i komandimit fillon nga dita e nesërme (sot është data 16), fillon më datë 17 shtator dhe sipas Kodit të Procedurave Administrative, duhet të përfundojë pas 1 viti, që korrespondon me datën 16 shtator 2021.

Ky ishte komenti i vetëm i zotit Bici.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

(Vota e zotit Bici nuk dëgjohet nëpërmjet platformës, ndaj i sugjerohet që ta shkruajë votën. Zoti Bici është Pro.)

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi vendimin “Për caktimin e gjyqtares në skemën e delegimit znj. {...}, në Gjykatën e Apelit Korçë”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Me kaq po mbylлим mbledhjen e ditës së sotshme.

Uroj punë të mbarë!

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor